

NGJITËSIT E PLLAKAVE



INTRAKOLL C2T

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë, Gri	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento me forcë ngjitëse të përmirësuar. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë. Ka rezistencë të mirë ndaj lagështisë dhe fortësi të njëtrajtshme. I klasifikuar si ngjitës C2T sipas standartit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikes, gresit, gres-porcelanit etj. Përdoret për dysheme dhe mure me bazë çimento, në ambiente të jashme dhe të brëndshme. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione 5-50 cm.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieni 6.5-7 litra ujë të pastër me 25 kg Intrakoll, përzieni masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene edhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzieni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Të gjitha tipet e suporteve me bazë çimento duhet të pastrohen paraprakisht përpara se të aplikohet produkti. Suporti mund të përmbajë papastërti të tilla si pluhura, vajra apo mbetje të ndryshme që ndikojnë negativisht në aplikimin e ngjitësit. Pastrimi mund të bëhet në mënyrë mekanike.



APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe me pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Konsumi 3-5 kg/m², sipas dimensioneve të dhëmbëzimit të shpatullës dhe tipit të bazamentit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e korigjimit: 30 min
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Mbushja e fugave në mure: Pas 8 deri 12 orësh
Ngjyra: E bardhë, Gri	Mbushja e fugave në dysheme: Pas 24 orësh
Konsumi: 3-5 kg/m ²	I shkelshëm: Pas 24 orësh
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse pas 28 ditësh: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	FN pas zhytjes në ujë: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Masa Vëllimore: 1.5-1.6 gr/cm ³	FN pas reaksionit nga ngrohja: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: $\geq 1 \text{ N/mm}^2$
Ujë për përzierje: 6-6.5 litra ujë për 25 kg	Rrëshkitshmëria: $\geq 0,5 \text{ mm}$
pH i përzierjes: 13	
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	



KUJDES! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përsheptim në tharje të produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Për pllaka me dimensione të mëdha dhe të rënda.
- Për ambiente me ngrohje qëndrore, në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme, suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.